



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), lidhur me nenin 14, dhe 17, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 6, paragrafi 1, pika 1.2, lidhur me nenin 8, paragrafi 1, pika 1.2, e konform nenit 19, paragrafi 3, pika 3.1 dhe 3.2 të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr. 10/2019” dhe neneve 15, 29, pika 2, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datë, 29.01.2021, miraton këtë:

V E N D I M

Neni 1

1.1 Shoqatës bëmirëse **“Jetimat e Ballkanit”**, me seli në Komunën e **Prizrenit, Rr. “Bekim Muhaxheri” Nr. 18**, të cilën e përfaqëson **Berat Kabashi-Përfaqësues i autorizuar i organizatës: I jepen** në shfrytëzim afatgjatë për **99, (nëntëdhjetë e nëtë)** vite prona e paluajtshme të Komunës si më poshtë:

1.1.1 **Parcela** kadastrale, **P-72116009-00061-0**, me sipërfaqe të përgjithshme prej; **78430m²**, sipas certifikatës së pronës **nr.11-463-3841/2020**, datës 20.10.2020, zona kadastrale **Gelancë**, vendi i quajtur **“Tarazhda”** e evidentuar pasuri shoqërore në emër të Kuvendit Komunal Suharekë, me destinim zonë Bujqësore.

1.1.2 **Parcela** kadastrale, **P-72116009-00062-0**, me sipërfaqe të përgjithshme prej; **3599m²**, sipas certifikatës së pronës **nr.11-463-3841/2020**, datës 20.10.2020, zona kadastrale **Gelancë**, vendi i quajtur **“Tarazhda”** e evidentuar pasuri shoqërore në emër të Kuvendit Komunal Suharekë, me destinim zonë Bujqësore.

1.1.3 **Parcela** kadastrale, **P-72116009-00063-0**, me sipërfaqe të përgjithshme prej; **1199m²**, sipas certifikatës së pronës **nr.11-463-3841/2020**, datës 20.10.2020, zona kadastrale **Gelancë**, vendi i quajtur **“Tarazhda”** e evidentuar pasuri shoqërore në emër të Kuvendit Komunal Suharekë, me destinim zonë Bujqësore.

1.1.4 **Parcela** kadastrale, **P-72116009-00064-0**, me sipërfaqe të përgjithshme prej; **500m²**, sipas certifikatës së pronës **nr.11-463-3841/2020**, datës 20.10.2020, zona kadastrale **Gelancë**, vendi i quajtur **“Tarazhda”** e evidentuar pasuri shoqërore në emër të Kuvendit Komunal Suharekë, me destinim zonë Bujqësore.

1.1.5 **Parcela** kadastrale, **P-72116009-00065-0**, me sipërfaqe të përgjithshme prej; **200m²**, sipas certifikatës së pronës **nr.11-463-3841/2020**, datës 20.10.2020, zona kadastrale **Gelancë**, vendi i quajtur **“Tarazhda”** e evidentuar pasuri shoqërore në emër të Kuvendit Komunal Suharekë, me destinim zonë Bujqësore.

1.2 Pronat e cekur më lartë jepen në shfrytëzim për ushtrimin e veprimtarisë Bujqësorë, sipas rekomandimit 01-Nr-463-1854 të datës 11.01.2021, të komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 2

Afati për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme të Komunës fillon të rrjedh nga data, 29.01.2021, dhe përfundon afati më datën, 28.01.2120, pas mbarimit të këtij afati ose ndërprerjes së parakohshme të kontratës e drejta e shfrytëzimit i kthehet Komunës së Suharekës si titullar faktik dhe juridik.

Neni 3

3.1 Obligohet; Kryetari i Komunës që me **personat fizik përfitues të pronës së paluajtshme të cekur më lartë**, të lidh kontratë me të cilën i përcaktojnë të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.

3.2. Obligohen; përfituesit e pronave të paluajtshme të Komunës, konkretisht personat fizikë të cekur në neni 1, të këtij vendim, që në afat prej 10, (dhjetë) dite nga data e miratimit të këtij vendim të sjellin garancioni bankar ose sigurimin nga kompanit e sigurimeve të licencuar në Republikën e Kosovës dhe atë 10% të vlerës së propozuar investive.

3.3 Nëse personat e cekur në paragrafin 2, të nenit 3, të këtij vendimi nuk e sjellin dokumentacionin e kërkuar në afatin ligjor, konsiderohet se ka hequr dorë nga shfrytëzimi i pronës së paluajtshme.

Neni 4

4.1 Obligohen shfrytëzuesit e cekur në nenin 1, të këtij vendimi, që pronën e paluajtshme të cekur në nenin 1, të këtë vendim, ta shfrytëzojnë me mirëbesim si nikoqir i mirë, që mos t'ia humbë vlerën e saj.

4.2 Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Suharekës dhe si e tillë ajo nuk mund t'i epet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.

Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr-10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËSNË SUHAREKË

01-Nr- 016-7542
Më datë 29.01.2021



Kryesuesi i Kuvendit

[Signature]
Mr.ec Bexhet KUÇI